



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic Of Kosovo

Komuna Rahovec / Opština Oraovac / Municipality Rahovec

RAHOVEC / ORAHOVAC

Drejtoria për Shërbime Publike
Odeljenje za Opštinske Javne Usluge
Department of Municipal Public Services

Njësia Nr./Br./No 01 (Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 21/93 Nr. i faq/Br.str./No.pg 2

Data/Datum/Date 29.07.2020

Datë/Datum/Date:	07.07.2020
Referenc-ë	
Për/Za/To:	Afrim Dina, Kryesues i Kuvendit Komunal të Rahovecit
CC:	Anëtarët e Kuvendit Komunal
Përmes/Preko/Through:	
Nga/Od/From:	z.Përparim Krasniqi, Drejtor për Shërbime Publike
Subjekti/Predmet/Subject:	Informatë

Informatë mbi implementimin e Planit për Investime në Hapësirat e Hapura Publike në Komunën e Rahovecit

Komuna e Rahovecit ka planin 5 vjeçar të mirëmbajtjes së hapësirave të hapura publike 2016-2021 i miratuar në dhjetor të vitit 2016 nga ekspert të fushave të drejtorisë së shërbimeve publike si dhe me ndihmën e eksperteve të projektit DEMOS, ku edhe është mbështetur ky plan.

Komuna ka sipërfaqe prej 275,5 km², me 35 vendbanime dhe një qendër urbane, ku në të gjithë territorin e komunës sonë, janë përfshirë hapësirat për mirëmbajtje.

Zonat e përfshirjes së HHP-ve në këtë dokument përfshijnë;

1. Mirëmbajtjen e gjelbërimit, të ulët, të mesëm dhe të lartë,
2. Mirëmbajtjen e ambienteve të ndërtuara, sheshe, shtigje për këmbësorë dhe sipërfaqe të shtruara,
3. Mirëmbajtjen e hapësirave për parkim automjesh
4. Mirëmbajtjen e ndriçimit publik në kuadër të HHP-ve, në kuadër të kësaj strategjie, mirëmbajtja e ndriçimit publik është kontratë e veçante nga kontrata për mirëmbajtjen e hapësirave publike.
5. Mirëmbajtjen e varrezave, lapidareve, pllakave përkujtimore, etj..

Të dhënat mbi sipërfaqet aktuale të HHP-ve në qytetin e Rahovecit janë këto:

- Parqe gjelbërime, 6944 m²
- Sheshe, 865m²
- Shëtitore pranë lumit, 3100 m²
- HHP-të pranë lapidareve, 44 m²
- HHP-të pranë pllakave përkujtimore, 4552 m²

KOMUNA RAHOVEC

Drejtoria për Shërbime Publike
Adresa: Xhelal Hajda – Toni p.n. Rahovec, Kosovë
Tel: +383 29 276 943
E-mail: info@komuna-rahovec.org

- Varreza të dëshmoreve, 7528 m2
- Varreza të martireve, 4750m2
- Varreza në zonën urbane, 99921.5 m2
- Varreza në zonën rurale, 147997 m2

Ne, duke e respektuar rekomandimet dhe planin e aprovuar, si komunë e Rahovecit kemi kontraktuar tre operator ekonomik që kanë kontratë me komunën e Rahovecit për mirëmbajtjen e hapësirave publike.

- Lot 1- 27,187.28 euro, në 40 lokacione është paraparë mirëmbajtja,
- Lot 2- 21,799.46 euro, në 37 lokacione,
- Lot 3 -19,726.92 euro, në 26 lokacione,
- Gjithsej 103 lokacione, duke përfshirë, varreza të dëshmorëve, lapidarëve, pllakave përkujtimore, sheshe, trotuare, rreth-rrotullime, hapësira të lira publike, etj...

Vlera e tyre në total për tre operator ekonomik sillet në **68,713.66** euro, derisa në vitin 2019 vlera në total për mirëmbajtje ka qenë **53,302.16** euro, kjo rritje është për shkak të krijimit të hapësirave të reja gjelbëruese që po bëhen çdo vit.

Synimet dhe objektivat specifike

Në kuadër të HHP-ve një ndër synimet kryesore është edhe ngritja e nivelit të mirëmbajtjes dhe përmirësimi i cilësisë, nëpërmjet planit të hartuar, si;

- Sensibilizimi i komunitetit për mirëmbajtjen e hapësirave publike, si dhe
- Rigjallërimi i HHP-ve, duke rritur sipërfaqet publike me parqe, drunjtë dekorativ, hapësira të gjelbëruara, investime në zonat e ndotura, rikthimi i atyre deponive ilegale në hapësira të gjelbëruara, mbjellja e drunjtëve dekorativ në rrugët kryesore dhe atyre lokale.

Tashmë kemi një rritje enorme nga viti në vit në kuadër të mirëmbajtjes së hapësirave publike, përveç investimit kemi rritje edhe në kosto financiare të mirëmbajtjes.

Me respekt,

Përparim Krasniqi

Drejtor i Shërbimeve Publike

01-Nr. 93/20

Me datë: 29.07.2020



KOMUNA RAHOVEC

Drejtoria për Shërbime Publike

Adresa: Xhelal Hajda – Toni p.n. Rahovec, Kosovë

Tel: +383 29 276 943

<http://www.komuna-rahovec.org>